

I Si të arrihet deri te komisionerja?

Shumë thjeshtë, me paraqitjen e ankesës.

Ankesën mund ta paraqesë secili njeri i cili konsideron se është i diskriminuar, dhe **në emrin e tij** dhe me pëlqimin e tij këtë mund ta bëjë edhe **organizata** e cila merret me mbrojtjen e të **drejtave të njeriut** ose ndonjë **person tjetër**.

Në ankesë duhet të theksohet: **kush** është i diskriminuar, **si** është diskriminuar dhe **kush** është diskriminues, si edhe **dëshmitë në disponim** për diskriminim.

Ankesa paraqitet në **formën me shkrim** dhe duhet të jetë e nënshkruar.

Aneksën mund ta dërgoni përmes telefaksit, me postë elektronike edhe, me gojë, në procesverbal.

Komisionerja nuk mund të veprojë sipas ankesave anonime.

Ankesën mund ta dërgoni në adresën:

Komisionerja për mbrojtjen e barazisë
Beogradska 70, 11000 Beograd
telefoni/faksi: 011 243 6464
e-maili: poverenik@ravnopravnost.gov.rs

Adresa e zyrës për pranim të qytetarëve:

Rruga Nemanjina 22-26, Beograd
Caktimi i takimeve nëpërmjet telefonit në
011 243 8020 dhe 011 243 6464

www.ravnopravnost.gov.rs



ПОВЕРЕНИК ЗА
ЗАШТИТУ
РАВНОПРАВНОСТИ



ПОВЕРЕНИК ЗА
ЗАШТИТУ
РАВНОПРАВНОСТИ

Barazia e drejtë e jona dhe përgjegjësi e jona

Komisioneri për mbrojtjen e barazisë është organ i pavarur dhe individual, i specializuar për luftën kundër diskriminimit



Shtypja e kësaj broshure është finansuar nga Delegacioni i UE në Serbi, përmes projektit IPA 2011 " Zbatimi i politikave antidiskriminuese në Serbi"

Albanski jezik



Çfarë është diskriminimi?

Diskriminimi është secila **bërje e paarsyeshme e dallimit ose veprim i pabarabartë** (përfshirimi, kufizimi ose dhënia e përparësisë) në krahasim me **personat ose grupet, në mënyrë të hapur ose të fshehur**, në bazë të ndonjë veçorie të tyre personale, siç është raca, ngjyra e lëkurës, shtetësia, përkatësia kombëtare ose origjina etnike, gjuha, bindja fetare ose politike, gjinia, orientimi seksual dhe etj.

Diskriminimi është veprim jo i barabartë ndaj të barabartëve dhe veprim i barabartë ndaj jo të barabartëve.

Format e diskriminimit

- diskriminimi i drejtpërdrejtë
- diskriminimi indirekt
- shkelja e parimeve e të të drejtave dhe obligimeve të barabarta
- ndalimi i marrjes në përgjegjësi
- bashkimi për të bërë diskriminimin
- fjala e urrejtjes
- nënçmimi dhe shqetësimi
- format e rënda të diskriminimit (racial, kombëtar, intoleranca fetare, diskriminimi shumëfish, diskriminimi nga ana e organeve shtetërore, tregtia me njerëz.)

Çfarë nuk është diskriminimi?

Nuk është secila bërje e dallimit diskriminim. Ekzistojnë raste kur të bërit dallim është i arsyetueshëm dhe i lejueshëm.

Për shembull, është i lejueshëm trajtimi i pabarabartë me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës për ushtrimin e të cilës nevojitet që personi i punësuar të ketë ndonjë veçori të veçantë personale (arsimin e lartë, aftësi të caktuara psiko-fizike dhe të ngjashme).

Bazat e diskriminimit

- raca, ngjyra e lëkurës, paraardhësit, shtetësia, përkatësia kombëtare ose origjina etnike, gjuha, bindja fetare dhe politike,
- gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual,
- gjendja pronësore, lindja, veçantitë gjenetike, gjendja shëndetësore, invaliditeti,
- statusi martesor dhe familjar, mosha, pamja,
- dënimi penal,
- anëtarësimi në organizatat politike, sindikale dhe në organizatat tjera, dhe
- secila veçori tjetër reale ose e supozuar personale

Çfarë mund të bëjë komisioneri?

Pajtimi

Para se që të ndër marrë çfarëdo qoftë, Komisioneri mund të propozojë pajtimin, që personi i diskriminuar dhe diskriminuesi me ndihmën e pajtuesit të tejkalojnë problemin.

Dhënia e mendimeve dhe rekomandimeve

Kur e merr ankesën, komisioneri e zbaton procedurën, e konstaton gjendjen faktike dhe e jep mendimin a është bërë diskriminimi, e nëse është bërë, e rekomandon diskriminuesin si të mënjtojë shkeljen e të drejtës. Nëse diskriminuesi nuk vepron sipas rekomandimit, komisioneri ia lëshon vërejtjen, e nëse edhe pas kësaj nuk vepron sipas rekomandimit, *e njohton opinionin.*

Ngritja e ankesës

Nëse vlerëson se është e nevojshme, komisioneri mund të fillojë procesin gjyqësor, me pëlqimin e personit të diskriminuar.

Paraqitja e denoncimit kundërvajtës

Komisioneri e paraqet denoncimin kundërvajtës për shkak të shkeljeve të cilat janë përcaktuar me ligjet antidiskriminuese.

Procedura e ankesave zgjat më së shumti 90 ditë dhe plotësisht është falas.

Me besim në komisioneren



Prof. dr. Nevena PETRUSHIQ

Komisionere për mbrojtjen e barazisë

Është profesoreshë e rregullt e Fakultetit Juridik në Universitetin e Nishit. Derisa është zgjedhur për komisionere ka qenë dekane e fakultetit. Është autore e mbi 20 librave shkollorë, monografive, studimeve dhe doracakëve dhe më shumë se 150 artikujve shkencorë dhe profesionalë. Është aktive në sektorin joqeveritar, sidomos në fushën e të drejtave të njeriut dhe të barazisë gjinore. Është fituese e çmimit të OSBE.

Lufta kundër të të gjitha formave dhe aspekteve të diskriminimit është misioni ynë dhe kuptimi i punës sonë. Prandaj dua t'ju bind se secila ankesë e Juaj do të shqyrtohet me kujdes dhe në rast të diskriminimit për t'ju mbrojtur do të përdorim të gjitha mjetet në dispozicion. Diskriminimi nuk guxon të tolerohet. Prandaj reagoni dhe kërkoni mbrojtjen! Secili rast i diskriminimit i përfunduar me sukses do të jetë kontribut i çmuar për ndërtimin e shoqërisë demokratike dhe tolerante në të cilën të gjithë qytetarët dhe qytetarët kanë shanse të barabarta që në mënyrë të barabartë, aktive dhe në mënyrë produktive të marrin pjesë në të gjitha segmentet e jetës shoqërore.

Dr. Nevena Petrushiq